SHABAN ÇUPI

COVIDI 19

NË TREVËN E HANIT TË ELEZIT

DHE PASOJAT E TIJ

2020-2023

Covidi 19 dhe pasojat e tij në trevën e Hanit të Elezit

Të dhëna të përgjithshme

Gjatë historisë, sëmundjet ngjitëse e që zakonishtë në gjuhën popullore quhej ,,mortja e zezë'', shpesh kanë përfshirë edhe hapësirën shqiptare duke lënë pasoja të mëdha në popullatë.

Gjatë gjithë shekujve u përhapën epidemi të ndryshme me pasoja të mëdha njerëzore. Në shekullin XIV, më sakt gjatë viteve 1347-1353 u përhap një epidemi e cila jo vetëm që përfshiu Europën, por preku edhe hapësirat e Ballkanit. Mortja e zezë, këtyre trevave goditi edhe gjatë viteve 1650-1660 dhe sipas udhëpërshkruesit turk Evlia Çelebiut vetëm në Prizren shoi mijëra jetë. Murtaja u përhap edhe në kohën e Pjetër Bogdanit 1689-1690. Kjo sëmundje u përhap edhe gjatë viteve 1737-1740 dhe shkatërroi shumë familje, saqë udhëpërshkrues të ndryshëm thonë se në Kaçanik nuk gjetën asnjë banorë, ose i ka zhdukur murtaja ose kanë ikur maleve.

Se si ishin pasojat e murtajës në Gjakovë të vitit 1746, mjafton të lexosh Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit e në anën tjetër edhe metodat për izolimin dhe shërimin e sajë. Saherë që kjo sëmundje e zezë goditi Shkupin dhe Kaçanikun, si zonë e ndërmjetme është goditur edhe treva e Hanit të Elezit. Një goditje virusale, jo pak shqetësuese e quajtur Covidi 19, ndodhi edhe në shekullin XXI, më saktë nga viti 2020-2023.

COVIDI 19 në Han të Elezit

Koronavirusi i përcaktuar si SARS-COV-2 apo siç u quajt ndryshe COVIDI 19, për herë të parë u shfaq në Kinë, më sakt në provincën Wuhan të Kinës në muajin nëntor ose dhjetor të vitit 2019. Mendohet se origjina e tij ishte shtazore dhe me shpejtësi të madhe u përhap duke përfshirë tërë globin. Vetëm për periudhën 2020-2021, sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), humbën jetën 14.9 milionë njerzë, ndërsa në Kosovë nga COVIDI 19 duke iu referuar Institutit Kombëtar të Shërbimit Publik të Kosovës (IKSHPK), humbën jetën 3014 njerzë, ndërsa në komunën e Hanit të Elezit si pasojë e Covidit 19, humbën jetën 8 banorë të kësaj komune, ndërsa numri i të infektuarve ishte i madhë. Ky virus vdekjeprurës, përhapej nëpërmjet kantaktit fizik me njerëz, frymëmarrjes, kollitjes dhe teshtitjes. Organet që sulmonte virusi ishin mushkritë. Pas sulmit të virusit, periudha e inkubacionit shfaqej ndërmjet ditës së dytë deri në të katërmbëdhjetën.

Institucioni komunal në ballë të luftës kundër koronavirusit

Më 16 mars 2020, komuna e Hanit të Elezit themeloi Këshillin komunal për zbatimin e masave parandaluese kundër COVID 19. Ky Këshill mori në përgjegjësi analizën e situatës dhe masave parandaluese kundër Covidit 19.

Në përbërje të Këshillit komunal për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid 19, ishin: Kryetari i komunës, Drejtoria komunale për Shëndetësi, Arsim dhe Shërbime Publike, Stacioni policorë, Policia kufitare, Policia e vijës së gjelbërt, QKMF-ja, Qendra për Punë Sociale, Inspektorja sanitare dhe e Mjedisit. Për zbatimin e masave anticovid, ky Këshill duhej të ishte në kordinim të plotë me vendimet e Qeverisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKSHP-së.

Këshilli që në takimet e para konstatoi se jemi ndër komunat me rrezikshmëri të lartë sepse jemi zonë kufitare me qarkullim të madhë të udhëtarëve e mallrave. Si mjet masiv për të komunikuar me qytetarë u përdorën rrjetet sociale ku edhe prezantoheshin masat për mbrojtje nga koronavirusi.

Më 10 prill 2020 në Han të Elezit shënohet rasti i parë i infektuar me COVID 19. Burimi i infeksionit ishte nga Kampi Bonstil, sepse i infektuari ishte punëtor i një ndërmarrje që kryente shërbime në këtë Kamp.Nga familja e të infektuarit janë marrë 8 mostra, nga të cilët 6 kanë rezultuar pozitiv, pra që në hapin e parë, kjo trevë shënon 7 raste me infektim Covid 19 dhe ky numër në rrjedhë të kohës do të rritej me të madhe.

Si pasojë e COVID 19, që në periudhën e parë të pandemisë, u mbyllën institucionet shkollore, u mbyllën xhamitë, tregjet, u mbyllën restorantet, u ndërpre puna në kantiere, u ndërprenë dasmat, ahengjet, lëvizjet në grupe, edhe varrimi bëhej vetëm në rrethana familjare, u ndërprenë të pamet në raste mortore, manifestimet e çka jo tjetër. Me një fjalë vepronin vetëm segmentet e domosdoshme si institucioni komunal, QKMF, policia, stacioni kufitarë dhe marketet që furnizonin popullatën me artikuj ushqimorë. Gjithçka pësoi kolaps dhe fillimisht nuk dihej se sa do të zgjaste kjo situatë. Njerëzit mbetën të mbyllur, mbetën në izolim. Spitalet u mbushën me pacientë dhe vdekjet, në nivel shteti, ishin pothuajse të përditshme. Ekonomia edhe ashtu e brishtë, gjatë periudhës së pandemisë mori goditje të rëndë.

Ndërkohë në çdo institucion u formuan TASKFORCAT për menaxhimin e situatave. Në çdo pikë frekuentuese u vendosën dezinfektues. Mbajtja e maskës në gojë e hundë ishte e detyrueshme si dhe distanca ndërmjet dy personave duhej të ishte 1.5 metra.

Gjithnjë duke iu referuar Raporteve komunale dhe procesverbaleve të Kuvendit komunal, situata gjatë periudhës mars-qershor 2020, disi mbahej në kontroll sepse u përkufizuan lëvizjet, madje edhe nga jashtë që hynin në Kosovë, por në muajtë pasues, si në korrik e gusht e sidomos në nëntor 2020, numri i të infektuarve u rritë e për pasojë do të shënohen edhe dy raste me fatalitet.

Cilat ishin simptomat e sëmundjes?

Simptomat e Covidit 19 ishin: Ethe ose temperaturë e lartë, kollitje e thatë, lodhje dhe humbje imuniteti, dhembje muskujsh, vështirësi në frymëmarrje, dhembje fyti, humbje e shijës në ushqim, dhembje koke, të vjelluara, diarre etj.

Përqindja më e madhe, paraqitej me ethe ose shprehur në përqindje ishte 87.9%, kollitja 67.7%, lodhja 38.1%, prodhimi i pështymës 33.4%, gulçimi 18.6%, dhembje muskulore ose të nyjeve 14.8%, dhembja e fytit 13.9%, dhembje koke 13,6%, të dridhura 11.4%, të vjella 5.0%.

Përballja me COVIDIN 19

Meqenëse Organizata Botërore e Shëndetësisë OBSH edhe zyrtarishtë koronavirusin e shpalli pandemik, Qeveria e Republikës së Kosovës mori vendim për ndërprerjen e mësimit në të gjitha nivelet nga 12 marsi deri më 27 mars 2020.

Duke iu referuar Ditarit tim personal, më 13 mars 2020, dy banorë të Kosovës u diagnostifikuan me koronavirus, njëri i moshës 20 vjeçare, ndërsa tjetri 77 vjeç. Në rrjedhë të ngjarjeve, MASHT-i lëshoi vendimin për mësim nga distanca, fillimisht, nxënësit u detyruan të përcjellin mësimin nga RTK, ku nëpërmjet këtij televizioni, mësimdhënës të caktuar shpjegonin njësitë mësimore. Ky ishte edhe hapi i parë, për të aktivizuar nxënësit.

Me vendim qeveritar, banorëve të Kosovës u kufizohet lëvizja përveç në raste emergjente. U ndalua edhe qarkullimi i automjeteve nga ora 10-16 dhe nga 20 deri në 6 të mëngjesit. Tanimë nxënësit, pos mësimit nëpërmjet RTK-së, filluan edhe mësimin online në platformën Zoom dhe Viber, filluan hapat e parë në mësim nga distanca dhe kjo po ndodhte për herë të parë si për nxënës e gjithashtu edhe për mësimdhënës. Tanimë kjo mënyrë pune online u përhap edhe në segmente të tjera të shoqërisë, duke përfshirë edhe Parlamentin e Kosovës dhe Qeverinë.

Në anën tjetër, udhëtarët që vinin nga vendet e jashtme, ose nga diaspora, detyroheshin që për 14 ditë me radhë të futen në karantinë që të vërtetohet se a është i infektuar apo jo. Brenda 14 ditëve ishte faza e inkubacionit të virusit. Konviktet e studentëve në

Prishtinë u shndërruan në qendra të karantinës, ndërsa në Han të Elezit, u ngrit tenda pranë QKMF-së. Në fshatra, duke pasur parasysh hapësirën natyrore, njerëzit kryenin punët e bujqësisë, por duke respektuar distancën dhe çdo familje u paisën me maska, dorëza dhe dezinfektues. Kështu veprohej në tërë hapsirën e trevës së Hanit të Elezit.

Barrën institucionale të menaxhimit të pandemisë e kishte komuna me drejtoritë përkatëse, ndërsa QKMF-ja me stafin e sajë mjekësor ishin në ballë të situatës. Personeli mjekësor i Hanit të Elezit, ballafaqohej drejtëpërsëdrejti me pandeminë dhe pasojat e saj, duke rrezikuar edhe vetë shëndetin e tyre. Krahas QKMF-së ekipet mjekësore ishin të angazhuara edhe në pikën kufitare në diagnostifikimin e udhëtarëve. Vlerësuar nga distanca, i tërë stafi mjekësorë në Han të Elezit ishte i angazhuar ditë e natë duke dhënë një kontribut madhorë me vlera të pamatshme. Krahas kësaj, vija tjetër që rrezikonin shëndetin e tyre ishin mësimdhënësit e të gjitha shkollave, pasiqë kontakti me nxënës ishte i përditshëm.

Stafi mjekësorë pranë QKMF-së në Han të Elezit gjatë vitit 2020 të cilët ishin në luftë të drejtpërdrejtë me virusin Covid 19

Paraqitje tabelare e të infektuarve me virusin Covid 19 gjatë vitit 2020

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	**Gjithsej**
Pozitiv-aktiv	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	**2**
Të inf. me COVID 19	0	0	0	7	0	0	6	10	9	7	29	10	**78**
Të hospitalizuar	0	0	0	0	0	0	3	1	2	0	6	3	**15**
Të dysh. me diag. klinike	0	0	0	0	0	0	18	43	10	15	62	22	**170**
Të vdekur	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1	**2**

Vendbanimi	**GJ**	%
Hani i Elezit	45	57.69
Gorancë	1	1.28
Paldenicë	9	11.54
Seqishtë	8	10.26
Lagja e re	12	15.38
Krivenik	1	1.28
Dimcë	2	2.56
Gjithsej	**78**	100.00

Profesioni	**GJ**	%
Amvise	13	16.67
FSK	1	1.28
Mësimdhënës	3	3.85
Nxënës	1	1.28
Pa punë	9	11.54
Pension	19	24.36
Pun. shënd.	13	16.67
Punëtor	19	24.36
Gjithsej	**78**	**100.00**

Mosha	**GJ**	%
0>vj.≤10	0	0.00
10>vj.≤15	1	1.28
15>vj.≤20	2	2.56
20>vj.≤30	7	8.97
30>vj.≤40	14	17.95
40>vj.≤50	12	15.38
50>vj.≤60	10	12.82
60>vj.≤70	17	21.79
vj>70	15	19.23
Gjithsej	**78**	100.00

Sipas tabelës, gjatë vitit 2020, shihet se:

- Sipas vendbanimeve më i infektuar është:
    - Hani i Elezit me 45 të infektuar apo 57.69% e të infektuarëve,
    - Lagja e Re me 12 të infektuar apo 15.38% e të infektuarëve,
    - Paldenica me 9 të infektuar apo 11.54% e të infektuarëve,
    - Seçishta me 8 të infektuar apo 10.26% e të infektuarëve etj
- Sipas profesioneve më të infektuar janë:
    - puntorët dhe pensionistat me nga 19 të infektuar apo me nga 24% e të infektuarëve,
    - puntorët shëndetësor dhe amviset me nga 13 të infektuar apo me nga 16.67% të infektuarëve,
    - të pa punë 9 të infektuar apo 11.54% e të infektuarëve etj.
- Sipas moshave me të infektuar janë:
    - Mosha 60-70 vjet me 17 të infektuar apo me 21.79% e të infektuarëve
    - Mosha mbi 70 vjet me 15 të infektuar apo 19.23% e të infektuarëve
    - Mosha 30-40 vjet me 14 të infektuar apo 17.95% e të infektuarëve
    - Mosha 40-50 vjet me 12 të infektuar apo 15.38% e të infektuarëve
    - Mosha 50-60 vjet me 10 të infektuar apo 12.82% e të infektuarëve
    - Mosha 20-30 vjet me 7 të infektuar apo 8.97% e të infektuarëve
- Sipas gjinisë me të infektuar:
    - Mashkuj 42 të infektuar apo 54.55% e të infektuarëve
    - Femra 36 të infektuara apo 45.45% e të infektuarëve

Cekëm edhe më lartë se në çdo institucion, gjatë vitit 2020 u formuan Taskforcat për menaxhimin e situatës së krijuar, dhe për të kuptuar situatën e rëndë që mbretëronte, sa për ilustrim paraqesim të fragmentuar situatën në shkollën fillore ,,Kështjella e Diturisë'' në fshatin Paldenicë. Situata, afërsisht ishte e njejtë edhe në shkollat tjera të kësaj treve si në SHFMU ,,Ilaz Thaçi'' në Han të Elezit, ate ,,Veli Ballazhi'' në Gorancë dhe në Shkollën e mesme ,,Dardania''.

Nga dokumentet tanimë arkivore të kësaj shkolle, na bëhet e ditur se:

Nga data 12 mars 2020 deri më 8 qershor 2020, mësimi është ndërprerë për shkak të pandemisë me vendim të MASHT-tit dhe DKA-së. Gjatë kësaj kohe, nxënësit nga klasa e parë deri në të nëntën, mësimin e kanë përcjellur nëpërmjet RTK-së dhe mësimit online përmes platformës ZOOM dhe Viber. Nga data 8 qershor 2020 mësimin e kanë

rifilluar në shkollë nxënësit e klasës së IX-të për përgatitjen e testit të arritshmërisë. Mësimi u zhvillua në kushte të jashtëzakonshme. Nxënësit dhe stafi shkollorë mbanin maska, respektojnë distancën dhe dezinfektimin, thuhet në një raport të kësaj shkolle. Por me 15 qershor 2020, sërish ndërpritet mësimi me vendim të MASHT-it sepse numri i të infektuarve rritej me të madhe në Kosovë.Kështu ishte pjesa e parë e vitit 2020, po si ishte pjesa e dytë?



E hënë 14.09.2020

Sot me datë 14.09.2020 filloi viti i ri shkollor 2020/21 në kohë pandemie. Pas një periudhe të gjatë kohore, nxënësit iu kthyen shkollës por me maska anticovid.

Mësimi u zhvillua në dy turne që d.m.th. në dy grupe

Grupi i parë filloi mësimin në ora 8⁰⁰ - 10⁴⁵, ndërsa grupi i dytë i nxënësve filluan mësimin në ora 10³⁵ - 12⁵⁰, orët mësimore nga 30 minuta

Duhet theksuar se para se të hynin nxënësit në shkollë, ata kanë qenë të pozicionuar në mënyrë, në pika, ku distanca e tyre ka qenë së paku 1.5 metra, është bërë matja e temperaturës, dhënia e maskave dezinfektimi i duarve.

Çdo gjë është në regull.

Kujdestare dite

1. [illegible]

Faksimil nga kujdestaria ditore në fshatin Paldenicë

Duke iu referuar Librit të kujdestarisë së shkollës fillore në Paldenicë, bëhet e ditur se viti shkollor 2020/2021, filloi në objekt shkollor më 14 shtator 2020. Po në këtë shënim ditor, thuhet se mësimi u zhvillua në dy turne, në dy grupe. Me një fjalë, klasa prej 20 nxënësish ndahej në dy grupe dhe ora zgjaste 30 minuta. Kjo bëhej për të ulur mundësinë e infektimit të nxënësve. Klasa 1,2,3,4,5 dhe 6 mësimin e filluan më 14 shtator, ndërsa klasa 7,8,9 me 21 shtator 2020 gjithashtu me dy ndërrime, përkatësisht grupe dhe krahas masave dezinfektuese nxënësit uleshin në skajet e bankës për të krijuar largësinë e nevojshme nga njëri tjetri dhe gjithsesi me maskë duke ua matur edhe temperaturën. Vlen të theksohet se vala e parë e COVIDIT 19 ka zgjatur deri në fund të majit 2020, por kjo nuk është e tëra, lufta me koronavirusin do të vazhdoj edhe më tej. Në kontekst të kësaj ngjarje, muaji maj ishte muaji i Ramazanit. Xhamitë ishin të mbyllura dhe më 24 maj 2020, nuk u fal as Bajrami.

Mësimi me dy grupe nxënësish është mbajtur deri më datën 12 tetor 2020 dhe nga kjo datë mësimi është mbajtur me klasë të plotë, por në skaje të bankave dhe duke respektuar të gjitha rregullat anticovid.

Duke iu referuar Ditarit personal të datës 1 qershor 2020, ndër të tjera thuhet se kufijtë tokësor u hapën, por me Maqedoninë jo, sepse atje virusi është tejet aktiv dhe me përmasa të mëdha. Gjithnjë në kontekst kohorë, gjatë kësaj kohe ka qenë i mbyllur edhe aeroporti në Prishtinë, ndërsa mësimi online kishte dy muaj e gjysmë që vazhdonte. Po në vitin 2020, si pasojë e virusit, në komunën e Hanit të Elezit vdiqën dy banorë të gjinisë mashkullore, ndërsa numri i të prekurve me këtë virus është i madhë.

Siç potencuam edhe më lartë, viti shkollor 2020/21, përshkak të pandemisë, filloi me vonesë, filloi më 14 shtator 2020. Gjysëmvjetori i dytë filloi me 18 janar 2021 dhe përfundon me 2 korrik 2021, ndërsa orët e humbura janë mbajtur ditëve të shtune.

Covidi 19 dhe lufta ndaj tij gjatë vitit 2021

Viti 2021 është viti ku Covidi 19 u shtri me të madhe dhe spitalet u stërmbushën me pacientë. Vlen të theksohet se që nga muaji mars 2021 filloi vaksinimi i popullatës. Në fillim procesi i vaksinimit ishte i ngadalshëm pasiqë mungonin vaksinat, por gjatë stinës së verës dhe vjeshtës së këtij viti u shtua furnizimi. Në Kosovë u përdorën vaksinat e llojit Pfizer dhe AstraZeneca. Edhe pse me vonesë u zbulua vaksina, dhe shtetet fillimisht furnizoheshin me vështirësi, në masë të madhe u përhapën teori të ndryshme konspirative rreth vaksinës. Sa për ilustrim sjellim rrëfimin e mjekut të spitalit të Ferizajt i cili në një rast më tha: Vitet më të rënda në punën time 25 vjeçare janë vitet e kohës së pandemisë. Spitali ishte i mbi ngarkuar me pacientë duke marrë oksigjeno-terapinë. Vdekjet ishin të përditshme, e në anën tjetër anëtarët e familjeve të pacientëve thonin që mos t`u jepnim vaksinën prindërve të tyre. Deri në këtë pikë arritën dyshimet dhe dilemat…

Viti 2021 shënohet si ndër vitet më të rënda në Kosovë sepse nga virusi humbën jetën shumë njerzë sidomos gjatë periudhës gusht-shtator.

Në trevën e Hanit të Elezit, gjatë vitit 2021, si pasojë e Covidit 19 humbën jetën edhe gjashtë banorë të tjerë, në mesin e tyre dy femra, duke e rritur numrin e përgjithshëm në tetë. Personat që vdiqën nga Covidi 19, varroseshin me sanduk të mbështjellur edhe me plastmas.

Nga Ditari personal i datës 6 gusht 2021, shkëpus edhe këtë pjesë:

,,Variant Delta i Covidit 19 po shënon rritje. Po i sulmon edhe fëmijët. Janë evidentuar rreth 250 raste. Paralajmërohen masa. Vaksinimi i domosdoshëm…''kurse në Ditar të datës 29 gusht 2021 kam evidentuar gjendjen kësisoji: Sot nga covidi u shënua numri më i madh i të vdekurve. Vetëm sot, në Kosovë kishte 36 të vdekur dhe mbi 1600 të infektuar. Këshilli i Sigurisë Kombëtare i Kosovës ka paralajmëruar mbledhje urgjente''. Në shënimet e datës 1 shtator 2021 kam shkruar se: QKMF në Han të Elezit është stërmbushur me njerzë që dojnë të vaksionohen. Stafi i vogël medicinal nuk po e përballon dot fluksin.

Po nga Ditari i datës 26 tetor 2021 kam shkruar se Zyrtarisht Covidi 19 në Kosovë ka filluar nga data 17 mars 2020. Kjo pandemi po vazhdon edhe sot, dikund më shumë e dikund më pak. Ka lënë pasoja të lloj-llojshme, mbi të gjitha ekonomike. Aktualisht po ngriten çmimet e artikujve bazë. Është ngritur çmimi i naftës dhe derivative të sajë. Është paralajmëruar shtrenjëtimi i rrymës e rrjedhimisht do të bëhemi edhe më të varfër se sa kemi qenë.

Po gjatë këtij viti 2021 u bë edhe vaksinimi masiv i popullatës dhe ky imunizim ndikoi edhe në zvogëlimin e të infektuarve, ndërsa lufta vazhdonte edhe më tej. Megjithate, viti 2021 dallon nga faza e parë e vitit 2020 ku u paralizua gjithçka. Pavarësisht virusit, njerëzit u adaptuan me këtë mënyrë jetese me maska, dorëza, distancë e dezinfektues. Jeta dhe puna vazhdonin, por gjithnjë duke respektuar rregullat anticovid.

Përshkak të pandemisë, viti shkollor 2021-2022 ka filluar me vonesë, ai filloi më 27 shtator 2021.Në anën tjetër, shumica e mësimdhënësve kohë pas kohe infektoheshin nga virusi duke krijuar probleme të zhvillimit të mësimit edhe ashtu në kushte të jashtëzakonshme. Si përjetues i kësaj situate, pasiqë edhe vetë isha mësimdhënës i kësaj shkolle, ndaj mendimin se stafi arsimorë gjatë kohës së pandemisë ishte në nivel të lartë të detyrës, ishin sakrifikues dhe pavarësisht kësaj gjendje të rëndë, jepnin maksimumin për të arritur objektivat në procesin edukativo arsimor.

Në Ditarin e datës 27 janarit 2022 kam evintuar se,, në nivel të Kosovës, virusi sërish është në rritje. Shumë arsimtarë dhe nxënës kanë rezultuar me Covid 19. Rrezikojmë të mbyllen sërish shkollat''.

Marrë në tërësi viti 2020, 2021 dhe 2022 përshkak të pandemisë, ishin vite shumë të rënda për trevën e Hanit të Elezit dhe jo vetëm. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 u rrit numri i të infektuarve. Njerëzit mbetën të pasigurt dhe të izoluar. Mbetën në depresion e me shumë ankth. Nuk është e tepërt të thuhet se njerëzit prisnin vdekjen. Ishte pasiguri e madhe. Megjithate, maska u bë mjet jetese, por njëkohësisht u shndërrua në mjet shprese, ndërsa distanca u shndërrua në normë ligjore.

Gjatë vitit 2022, përshkak të imunizimit të popullatës u zbuten edhe masat kufizuese. dhe jeta filloi të merr hapat e normalitetit, ndërsa viti 2020 dhe 2021 ishin të rëndë dhe do të mbahet mend gjatë në memorien popullore të kësaj treve. Koronavirusi apo COVIDI 19 siç u quajt ndryshe,në komunën e Hanit të Elezit mori jetën e 8 personave, ndërsa numri i të infektuarve ishte i madhë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë me 5 maj 2023 zyrtarisht e shpalli të mbyllur fundin e emergjencës globale të COVID 19. Pas këtij vendimi edhe institucionet e Kosovës hoqën masat e mbetura kufizuese dhe pandemia nuk u trajtua më si gjendje emergjente.

Për ta ilustruar edhe më tej gjendjen e krijuar nga Covidi 19 i referohemi disa procesverbaleve nga faqja elektronike e Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit ku për çdo mbledhje të Kuvendit, një pikë nga rendi ditës i kushtohej gjendjes së krijuar. Nëpërmjet këtyre procesverbaleve mësojmë detaje të tjera dhe plotësojnë atë që synojmë ta themi.

[redacted]:- në dy mbledhjet e jashtëzakonshme të cilat i kemi pasur jeni njoftuar për aktivitete dhe punët të cilat janë bërë gjatë situatës me pandeminë. Nga muaji shkurt jemi mundur me i zbatuar vendimet të cilat janë dërguar nga niveli qendrorë . Edhe pse kemi pasur mungesë stafi vazhdimisht ishim në pikën kufitare dhe kemi pasur 5282 kontrolla të shoferëve të cilat janë kryer dhe prej tyre 59 udhëtarë që në bazë të rekomandimeve të instituti i kemi përcjell për karantinë në qendrën e studente në Prishtinë. Gjatë muajit majë edhe pse nuk ka përfunduar i kemi pasur 6421 kontrolla prej tyre 165 janë vazhduar për qendrën e studentëve në Prishtinë. Gjatë muajit prill në QKMF i kemi ndërprerë disa shërbime në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë të cilat ishin për të mirën dhe për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, mirëpo me zbutjen e masave këto shërbime kanë filluar dhe sot kemi pranuar vendimin nga qeveria që e liron secilin udhëtarë nga karantina por secili udhëtarë që do të kalon do të ketë vetëm vetizolimin shtëpiak . Ne kemi me vazhduar që me i pasur ekipet mjekësore në kufij. Janë ndarë edhe ndihma për familjet me nevojë dhe numri është 1121 pako të cilat janë shpërndarë gjatë kësaj periudhe. Gjithsejtë ishin shtatë persona me COVID pozitiv . Me datë 23. 05.2020 e kemi pasur edhe pacienten e fundit e cila e ka kryer pjesën e vetizolimit dhe për momentin nuk kemi asnjë të infektuar në komunë.

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 23.6. 2020

[redacted]tuata rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit është stabile. Ministria i ka njoftuar qytetarët të cilët i kanë marr dozën e dytë të vaksinës se mund ta marrin edhe dozën e tretë. Edhe pse nuk kemi pasur ndonjë rast të shënuar me kovid -19 fluksi i pacientëve është rritur gjatë dy javëve të para të këtij muaji për shkak të gripit sezonal , mirëpo për momentin është qetë situata me gripin sezonal . Si drejtori jemi përgatitur dhe i kemi marr të gjitha masat në rast të paraqitjes së rasteve me virusin omikron dhe jemi duke bërë apel te ata qytetarë të pakët të cilët kanë mbetur pa u vaksinuar që të marrin vaksinat. Deri më tani janë vaksinuar 8666 qytetarë e që prej tyre me një dozë janë vaksinuar 4618 qytetarë, me dy doza janë vaksinuar 4048 qytetarë , ndërsa me dozën e tretë janë vaksinuar 11 qytetarë. Nga data 14 dhjetorë sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë ka filluar vaksinimi për moshat nga dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjet dhe interesimi është shumë i vogël dhe deri më tani janë vaksinuar 57 nxënës. Në bashkëpunim me ekipin e vaksinimit ishim nëpër të gjitha shkollat, që të takohemi me të gjithë drejtorët e shkollave që ta sensibilizojmë çështjen vaksinimit .

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 19.1.2021

- në muajin shkurt do ta keni një informatë me shkrim për koronavirusin me të gjitha specifikat. Janë duke u bërë dy lloj testesh , testi serologjik që bëhet nga QKMF-ja dhe testi që bëhet nga instituti kombëtarë i shëndetit publik. Gjatë këtij muaji sipas institutit kombëtarë të shëndetit publik kemi pasur tre raste. Sa i përket testeve serologjike vetëm gjatë këtij muaji janë bërë 350 teste serologjike që shumica prej tyre dalin që e kanë kaluar, ndërsa një pjesë janë pozitiv. Në ambulantë deri në gjashtëdhjetë teste brenda ditës janë bërë dhe interesim të madh nuk ka për shkak se shihet që ka rënë niveli i koronavirusit në Han të Elezit për dallim prej herëve të tjera që zyrtarisht i konfirmoheshin rastet që ishin një , dy apo tre ndërsa gjendja në praktik në QKMF ishte krejt ndryshe se ishin njëqind raste apo ndoshta edhe më tepër. Në bazë testeve serologjike 65 % e qytetarëve e kanë kaluar koronavirusi dhe do të ishte mirë që edhe ju si anëtarë të kuvendit të komunës ta sensibilizoni te qytetarët çështjen e testeve që me ardhur dhe me i kryer për shkak se po hezitojnë e po mendojnë që bëhen vetëm për institucionet.

Faksimil nga procesverbali i mbledhjes se Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit të datës 16 shkurt 2021 ku shqyrtohej gjendja aktuale rreth COVIDIT 19

deri më tani janë kryer 1714 teste serologjike, ndërsa teste rapide gjithsejtë i kemi kryer 188 teste . Aktualisht i kemi 11 raste pozitive. Dy raste i kemi pasur të hospitalizuar , ndërsa pjesa tjetër është në vet izolim shtëpiakë. Është duke vazhduar vaksinimi kovid 19 dhe deri më sot që jam duke raportuar janë vaksinuar 247 persona, prioritet ka qenë personeli mjekësorë dhe pastaj sipas kategorive të personave të moshuar.

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 9.5.2021

në muajin gusht ka rritje të rasteve edhe pse kemi mungesë të stafit janë duke u zhvilluar punët mirë. Gjatë javës së kaluar janë kryer 163 testime dhe prej tyre 72 pozitiv dhe 91 negativ. Në total janë kryer 570 testime dhe prej tyre 180 pozitivë dhe 390 negativ. Aktualisht kemi 110 raste aktive pozitiv dhe 70 të shëruar. Është duke vazhduar puna edhe me ekipet vaksinimit vetëm me një orar për shkak të mungesës së mjekëve . Nga fillimi e deri më tani janë dhënë 3713 vaksina dhe prej tyre 2664 janë ata të cilët e kanë marr dozën e parë dhe 1049 janë ata të cilët janë vaksinuar me nga dy doza. Nga komiteti për imunizim jemi njoftuar se nuk guxojmë ta vaksinojmë pa termin.

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 21.9.2021

- nga data tetë prill deri më datë njëzet e gjashtë shtatorë janë administruar 6185 vaksina dhe prej tyre janë 3954 qytetarë të cilët janë vaksinuar vetëm me një dozë të vaksinës dhe 2231 të cilët janë vaksinuar me dy doza të vaksinës. Është punuar edhe gjatë ditëve të vikendit për dhënie të vaksinave sipas vendimit dhe kërkesës së Ministrisë përkatëse. Në sektorin e vaksinimit kemi punuar vetëm më një ndërrim për shkak të mungesës së mjekut. Janë kryer mbi 1400 teste rapide përmes laboratorit që është në QKMF. Janë 287 pacientë të cilët i kemi pasur pozitiv dhe fatkeqësisht kemi pasur 3 raste të vdekjes, aktualisht i kemi 6 raste pozitive të cilët janë në vetë izolim dhe asnjëri prej tyre nuk është hospitalizuar.

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 2.11.2021

[redacted] si në gjithë Kosovën po ashtu edhe në komunën tonë vërehet një rritje e dukshme e pacienteve me kovid-19, krahas gripit sezonal në ditët e fundit është rritur edhe numri i pacientëve me kovid, nga fillimi i muajit Janar deri me datë 26.01.2022 numri total i kontrolleve mjekësore është 802 nga të cilat kontrolla 50 raste rezultojnë me kovid-19 kryesisht moshë e re dhe të pa vaksinuar as me njërën dozë të vaksinës. Nga këto 50 raste 6 janë të shëruar dhe një i vdekur. Gjatë këtij muaji kemi mbajtur takim me Shtabin Emergjent dhe Task forcën Komunale për të ndërmarr masat e nevojshme në parandalimin e kësaj Pandemie. Vlen të ceket se tash e tutje vendimet për izolim dhe vendimet për lirim nga izolimi janë në kompetencë të Agjensionit Ushqimit dhe Veterinarisë për shkak se të gjithë inspektorët sanitar komunal kanë kaluar në kuadër të këtij Agjensioni me zyre regjionale ne Ferizaj. Vaksinimi në komunën tonë ka filluar me datë 08.04.2021 dhe është në proces e sipër ku deri me 26.01.2022 janë dhënë 9317 doza të administruara dhe prej tyre me dozën e parë 4756, me dozën e dytë 4262, me dozë e tretë 299, nxënës deri tani janë vaksinuar vetëm 123 .

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 16.2.2022

[redacted] është kthyer normaliteti dhe situata është e qetë. Në dy javët e fundit kemi vetëm një rast pozitiv, ndërsa sa i përket rasteve nga data 06.01.2022 deri më 28.02.2022 kanë qenë 128 raste pozitive. Procesi i vaksinimit është duke shkuar në mënyrë të rregullt dhe deri më tani doza të administruara janë 9668 doza. Me dozë të parë janë 4808, me dozë të dytë janë 4395 dhe me dozë të tretë janë 465 , ndërsa 159 nxënës janë vaksinuar. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Faksimil nga proceverbali i mbledhjes së Kuvendit komunal i datës 22.3.2022

Në procesverbalin e datës 19.04.2022 të Kuvendit Komunal, ndër të tjera thuhet se:

Gjendja ka filluar të stabilizohet. Deri më tani janë administruar 9732 doza, por ka ende qytetarë që nuk janë vaksinuar.

Koha e pandemisë nëpërmjet fotografisë

Rreshtimi i nxënësve në SHFMU,,Ilaz Thaçi'' Hani Elezit,2020

Kolektivi i SHFMU ,,Ilaz Thaçi'' në kohë pandemie

Një manifestim në kohë pandemie, mars 2021

Rreshtimi i nxënësve në kohën e pandemisë në oborr të shkollës, Paldenicë, 2020

Pamje nga mësimi në grupe, shtator 2020, Paldenicë dhe një nxënëse nga Hani Elezit duke mësuar online nga Viberi



Mbledhja online e arsimtarëve të SHFMU ,,Ilaz Thaçi'' në kohë pandemie

Një mbledhje e arsimtarëve në Han të Elezit në kohë pandemia kur mësimi filloi në objekte shkollore

Një pamje nga dezinfektimi i objekteve shkollore

Një pamje nga mësimi në grupe në Han të Elezit

Një pamje nga SHFMU „Veli Ballazhi'' Gorancë, gjatë një ore informuese rreth pandemisë

Një orë e Edukatës Figurative në kohë pandemie

Një mbledhje me drejtorët e shkollave dhe stafit komunal në kohë pandemie, 2021

Paisje mbrojtëse kundër Covidit 19 nga KFOR-i italian dhe FSK

Gjithçka nën maskë dhe në distancë-Paldenicë, 2020

Një nga mbledhjet e profesorëve në shkollën e mesme ,,Dardania'' në kohë të pandemisë

Një orë mësimore në shkollën e mesme ,,Dardania'' gjatë pandemisë

Jeta nën maskë

Paraqitje artistike e koronavirusit nga piktori i Hanit të Elezit, Arbër Etemi, punuar me teknikën e Bakërshkrimit



Pandemia e COVID-19 kishte ndryshuar rrënjësisht mënyrën e jetesës sonë dhe mënyrën e ndërveprimit me njëri-tjetrin, thotë piktori i trevës së Hanit të Elezit, Arbër Etemi. Maskat ishin bërë pjesë e përditshmërisë sonë, duke simbolizuar jo vetëm mbrojtjen dhe kujdesin, por edhe ndryshimet në komunikim dhe identitet. Në kontekstin e pandemisë, maska nuk është vetëm një mjet mbrojtës, por edhe një simbol i transformimit dhe adaptimit të shoqërisë ndaj një realiteti të ri. Unë kam shfrytëzuar këtë periudhë për të krijuar vepra që shprehin emocione të ndryshme, nga frika dhe pasiguria deri te shpresa dhe solidariteti. Përmes këtyre veprave, grafika ka luajtur një rol të rëndësishëm në dokumentimin dhe ruajtjen e përvojave të pandemisë, duke ofruar një perspektivë unike mbi ndikimin e saj në shoqërinë bashkëkohore dhe transmetimin e emocioneve tek brezi i ardhshëm, i cili nuk ka përjetuar këtë periudhë, thotë ai.

Përmbyllje

Nëpërmjet këtij hulumtimi, synuam të faktografojmë gjendjen e krijuar nga Covidi 19 dhe pasojat e tij. Kjo sëmundje ngjitëse jo vetëm që infektoi banorët e kësaj treve në masë, por edhe mori jetën e tetë personave. Njerëzit pësuan ankth, stres e traumë, sepse ,,mortja'' kalonte në mesin e tyre. Izolimi, maska e distanca u shndërruan në mjete jetese e shprese.

Në publikimin e këtij punimi, janë shfrytëzuar raporte e procesverbale nga institucioni i Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, janë shfrytëzuar fotografi të asaj kohe si dëshmi kohore, raporte shkollore si dhe Ditari personal i autorit.

Shaban Çupi

Tetor, 2025,Hani i Elezit